

NJOFTIM PËR LIKUIDIM
të

NSH N.N “Elan” – Fi – 485/89, Prizren

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:

DD “Elan” GP, Gjykata Ekonomike e Qarkut Prishtinë (Fi.6543/92) (19 Nëntor 1992)

Në bazë të nenit 39.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/6, Mbi Shoqëritë Tregtare, nenit 9 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 (e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/18) Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe nenin 43.3(d) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 Mbi riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre me autorizimin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, **ME ANË TË KËSAJ NJOFTOHET se likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar prej 6 Mars 2008**, në bazë të vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit më 18 Shtator 2007 sipas nenit 9.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12.

Në përputhje me nenin 43.3 (d) dhe (e) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, çdo person i cili beson se ai/ajo ka të drejtë kërkesë ndaj kësaj Ndërmarrjeje – qoftë si kreditor, apo në lidhje me çfarëdo lloj asetit që ka të bëjë me ndërmarrjen, apo si pronar i ndërmarrjes, si dhe çfarëdo kërkesë tjetër – **duhet të paraqesë Dëshminë e Kërkesës rreth Likuidimit deri më 31 Maj 2008**. Nëse nuk bëhet kjo, kjo mund të rezultojë që personat e tillë nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në ndarjen e fondeve të fituara nga likuidimi.

Formularët e Dëshmisë së Kërkesës rreth Likuidimit mund të merren dhe duhet të dorëzohen në ndonjërin prej këtyre zyrave të AKM-së:

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

Rruga: William Walker, Kompleksi i Farmakosit të Ri

Prizren, Kosovë/Kosovo

FAX: + 381 38 622 344

TEL: 038 504 604 8057

ose

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

Shtylla e IV-të e BE-së, Zyra në Beograd, Tolstojeva 47-49, 11000 Beograd, Serbi.

TEL: +381 (0) 11 367 4006

Formularët për kërkesa gjithashtu mund të merren edhe nga faqja e internetit e AKM-së në adresën www.kta-kosovo.org. Për detaje se si të dorëzohet kërkesa, shih “Si të paraqitni një kërkesë.”

Lista e asetëve dhe lista e paraqitësve të kërkesave do të mbahet në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në rrugën William Walker, Kompleksi i Farmakosit të Ri, Prizren dhe do të jetë e hapur për shqyrtim publik në këtë zyrë pas 6 Qershor 2008 (ose ndonjë datë tjetër që do të shpallet publikisht), deri në njoftimin e ardhshëm. Nëse keni arsye legjitime për pamundësinë e udhëtimit deri në vendin e lartpërmendur, ju lutemi të kontaktoni në adresën e mësipërme për të aranzhuar mënyrë tjetër të qasjes.

Asetet do të ofrohen për shitje nëpërmes tenderit me oferta të mbyllura në datën (jo me herët se 6 Prill 2008) që do të shpallet në të njëjtën mënyrë si edhe kjo shpallje duke përfshirë shpalljen edhe në faqet e internetit të AKM-së.